



01-177

Në bazë të nenit 21 të “Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013”; nenit 18 të “Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012”; nenit 21 dhe 44 të “Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 dt.21.06.2016”; nenit 17, pika “d” të “Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008”; nenit 15 pika “d” e “Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010”; “Regullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014”, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-26849/19 dt. 06.02.2019 të pronarit **Gazmend Tërllabuqi** nga Vushtrria, rr. “Ismail Qemali” p.nr. për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm, në parcelën kadastrale nr. 1438-8 ZK Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me dt. 06.03.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit **Gazmend (Shemsedin) Tërllabuqi** nga Vushtrria, rr. “Ismail Qemali” p.nr. sipas kërkesës 05 nr. 350/02-26849/19 dt. 06.02.2019, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm, me destinim “për pregaditjen e ëmbëlsirave” me etazhitet P+0, në kuadër të PZHU, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1438-8 ZK Prishtinë.

II. Këto kushte përcaktohen në bazë të kriterëve të “Regullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr.110-288305 dt. 31.12.2014”. Sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, parcela e lartcekur gjendet në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike” (e miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal nr. 031-20131 të dt. 31.05.2012) në bllokun ZI-12, e destinuar si “Zonë industriale”, ndërsa edhe me “Planin Zhvillimor Urban”, gjithashtu shtrihet në zonën me destinim “Zonë industriale”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - parcela nr.1438-8 ZK Prishtinë ka sipërfaqe të përgjithshme S=1.135,0 m²; Pronar i vetëm është Gazmend Tërllabuqi; parcela me kulturë është “arë e klasës 3”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale, parcela nr.1438-8 ZK Prishtinë është tokë bujqësore, me kulturë “arë e klasës 3”;
- Ky lokacion është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i rrafshtë;
- Qasja ekzistuese në këtë parcelë mund të realizohet përmes dy rrugëve ekzistuese, kah veriu prej rrugës “Lekë Matranga” ndërsa kah lindja prej rrugës “Sokol Rama”.
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa ekzistuese të ndërtuara, kryesisht me destinim banimor.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e kësaj ndërtese, në kuadër të në Prishtinë, bazuar në parametrat e “Regullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr.110-288305 dt. 31.12.2014”, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - “zgjdhja urbane”, bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës është afarist (punëtori për përpunimin e ëmbëlsirave), është me karakter të përkohshëm, andaj duhet të jetë i ndërtuar me elemente montazhe që lehtë demontohen, siq janë: hekuri, druri, plastika, apo edhe ndonjë material tjetër të ngjajshëm;
- Shfrytëzimi i parcelës sipas planit është 40 %, ndërsa sipas projekt - propozimit të prezantuar është 39 % e parcelës, e që është $S=441,70 \text{ m}^2$;
- Të respektohet etazhiteti i objektit i cili duhet të jetë përdhesë (P+0);
- Kuota e nivelit të përdhesës të jetë në njëjtin nivel të trotuarit, ose i ngritur max. 30 cm;
- Shfrytëzimi i nëntokës për bodrum nuk lejohet, gjithashtu galeria dhe shkallët brenda ndërtesës;
- Bazamenti i ndërtesës/themelet, mund të jenë nga betoni i armuar;
- Nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndërtimin e ndërtesës;
- Distanca e ndërtesave nga kufijt e parcelave fqinje duhet të jetë min. 0.5 H, por nëse në to ndodhen ndërtesat ekonomike, ndërtimi mund të bëhet në distancë më të vogël, por pa hapje në atë fasadë, nëse sigurohet pëlqimi i vërtetuar nga pronari i parcelës fqinje;
- Të sigurohen qasje dhe parkingje për automjetet përkatëse, min. nga 1(një) vendparkim për 30 m² të ndërtesës, ose 15 sosh sipas projekt-propozimit;
- Të sigurohet qasje e lirë përreth tërë ndërtesës, për qarkullimin e automjeteve të zjarrfikësve;
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet patur kujdes të veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;

V. Para aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesi duhet të plotësojë këto kritere:

- Të sjellë deklaratën e noterizuar se ndërtesa është me karakter të përkohshëm, dhe se do të njëjtin do t’a largojë në afat prej 8 (tetë) ditësh në rast të realizimit - zbatimit të Planit rregullues për atë hapësirë, ose në rast të ndryshimit të rethanave në bazë të cilave është dhënë leja ndërtimore e përkohshme;
- Të sigurohet pëlqimi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ndërrim të destinimit të tokës, meqenëse në bazë të Certifikatës së njësisë kadastrale, parcelat nr.1113-3, 1113-8 dhe nr.1113-9, sipas llojit të shfrytëzimit të parcelës janë tokë bujqësore “Arë e klasit ”. Konform dispozitave ligjore të Ligjit për tokë bujqësore nr.02/L-26 dt. 24.06.2005 dhe Udhëzimit Administrativ nr.41/2006 dt. 27.12.2006 që rregullojnë këtë fushë, pas marrjes së këtij pëlqimi, duhet të bëhet pagesa e taksës për ndërrimin e kulturës së tokës.

VI. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në Ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrikë dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos” - Ngrohitorja e Qytetit Sh.a. dhe” PTK”.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normat teknike për siguri nga zjarri, si dhe normat dhe standardet tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të pllatove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Deklaratat nga projektuesit e fazave të nevojshme për hartimin e Projektit Kryesor,
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit të firmës projektuese;
- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje, dhe një (1) në formë elektronike;
- Projektin e strukturës së ndërtimit/llogarinë statike, me përshkrimin teknik, pozicionimin dhe detajet e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro - energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaboratin "Organizimi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratës" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.



IX. Dokumentacioni ndërtimor për **Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

X. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore: meqenëse parcela kadastrale nr. 1438-8 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, sipas llojit të shfrytëzimit të parcelës është e evidentuar si tokë bujqësore me kulturë “Arë e klasit 3”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do t’i ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen prej $S=1.135,0 \text{ m}^2$.

Kjo sipërfaqe duhet të regjistrohet si tokë ndërtimore në regjistrat kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Ky kompensim / pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arrijtjen e kësaj marrëveshjeje.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit).

XII. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01 – 0094474/17 dt. 24.04.2017, dhe duke u bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Meqenëse lokali afarist nuk krijon densitet, sipas paragrafit 9.1, nënparagrafit “a” të kësaj rregulloreje, parashifet të bëhet vetëm pagesa e taksës administrative, e cila duhet të realizohet brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 nenit 16 të “UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017”, pas marrjes së konfirmimit të kryerjes së pagesës.

XIII. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimet për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronari **Gazmend (Shemsedin) Tërllabuqi** nga Vushtrria, rr. "Ismail Qemali" p.nr. me kërkesën 05 nr. 350/02-26849/19 dt. 06.02.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor /projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm, me destinim "pregaditjen e ëmbëlsirave", me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 1438-8, të evidentuar në Çertifikatën e njësisë kadastrale me P-71914059-01438-8 ZK Prishtinë;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Edon Maliqi me licencë nr. 155, lëshuar dt. 27.04.2016 nga MMPH;
- Projektin ideor të hartuar nga Sh.p.k. "Graphite Architecture" nga Prishtina, me Certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810124868 dt. 18.05.2018;
- Vërtetimin e tatimit në pronë nr. 23145/19 dt. 04.02.2018;
- Autorizimin për përfaqësim dhenë Ilir Krasniqit, të vërtetuar te noteri Ilmi H. Ademi, LRP.Nr. rendor 127/2019 me dt. 04.01.2019, që në emër të pronarit, të ndërmarrë të gjitha veprimet për marrjen e lejes ndërtimore në Drejtorinë e Urbanizmit;
- Fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit dhe të autorizuesit;
- Fotografitë e lokacionit.

Në procedurë të shqyrtimit të kësaj kërkesë, për shkak të prezantimit të gabuar të kërkesës, palës iu është pregaditë Vendimi për refuzim 05 nr. 350/02-026849/19 dt. 19.02.2019, të cilën ai e pranoi me 25.02.2019. Të njëjtën ditë, është mbajtur procesverbali, në të cilin i autorizuar i ka specifikuar se pronari nuk ka kërkuar ndërtimin e shtëpisë individuale, por ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm, me destinim për pregaditjen e ëmbëlsirave. Duke u bazuar në këtë sqarim, përmes shkresës zyrtare "Plotësim dokumentacioni" 05 nr. 350/02-026849/19 dt. 25.02.2019, nga pronari është kërkuar që të bëjë përmirësimin e projektit ideor, gjegjësisht në bazën e tij të heqë galerinë e paraqitur, të cilën ai e realizoi me shkresën/ankesë nr. 05-070/01-44787/19 dt. 26.02.2019.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 30.11.2018, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual të prezantuar, si dhe ankesës së parashtruar nr. 05-070/01-44787/19 me dt. 26.02.2019, konstatoi se ky projekt është në harmoni me UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, me kriteret e PZhK-së për atë hapësirë, prandaj kjo drejtori, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur Njoftimin publik me dt. 08.01.2019. Ky njoftim, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, dhe meqenëse në ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit konstatoi se kërkuesi ka



prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të “Regullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014” për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, prandaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.


Shtojcë: Situacioni i ngushtë - "dispozita”.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund t’i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Kërkuesit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorisë së Kadastrit, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie, dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-26849/19 dt. 06.03.2019**

Punoi:
Sh. Gorani



UD. Udhëheqëse e Sektorit:
Lindita Beqiri

